SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

jetojmë më mirë
së bashku

Newsletter
Bota e SIGAL UNIQA



Fatkeqësitë natyrore janë të papritura, por me SIGAL UNIQA ti je një hap përpara

Sigurimi i pronës
në SIGAL UNIQA

Bli Online
sigal.com.al

Ja ku takohemi sërish në Newsletterin “Bota e SIGAL UNIQA” për muajin Tetor 2023.
Me të tjera suksese dhe arritje dhe me dëshirën e stafeve të Grupit “SIGAL UNIQA” në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut për rezultate më të larta.
Më poshtë ju njohim me ngjarjet më të rëndësishme që shenjuan muajin tetor për Grupin SIGAL UNIQA, “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” dhe kompaninë mëmë “UNIQA Insurance Group”.

Lexim të këndshëm!

PËRMBAJTJA

Intervista/ CEO i “UNIQA”: U japim siguri mbi 16 milionë njerëz në Austri dhe pothuajse të gjithë Evropën Juglindore 2

20-vjetori / SIGAL UNIQA – Kosova, simbol i besueshmërisë, përgjegjësisë dhe shërbimit ekselent ndaj klientit 3

Raporti i AMF/ SIGAL UNIQA Group Austria, lideri i vërtetë i sigurimeve 5

SIGAL UNIQA, mes ‘Top 50’ kompanive më të mëdha të sigurimit në Evropën Juglindore 6

Ponari në “Wake UP”: Mbështetje financiare që secili të diagnostikohet dhe kurojë kancerin 7

Ponari: Kompanitë e sigurimeve në Shqipëri, të standarteve evropiane. Të gatshme të marrin përsipër rreziqet 8

Më të mirët në treg/ Edhe Florian Binaj ia beson KASKO-n e makinës SIGAL UNIQA-s 11

Rrëshqitja e tokës dëmton kantierin në Tiranë/ Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim, nevojë për çdo projekt 12

Fundjavë trajnimesh me stafet e SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut 14

Letra e hapur e Elvis Ponarit për bizneset: Siguroni të ardhmen e punonjësve tuaj me ‘SIGAL UNIQA Fond Pensioni’ 15

Mbyllet Maratona e Tiranës 2023, “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, një prej mbështetësve të eventit 16

SIGAL UNIQA lider i sigurimeve edhe në Kosovë/ Mbi 9.4 milionë Euro dëme të paguara, më shumë se çdo kompani tjetër 18

Sigurim Shëndetësor për futbollistët/ SIGAL UNIQA – Kosova: Mbetemi një mbështetje e fortë për sportistët dhe klubet 18

Dita Kombëtare e Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, “UNIQA” dhuron bursa për studentët e Matematikës 19

Makina Lëvizëse e dëmeve, ‘myUNIQA’, Inteligjenca Artificiale dhe inspektimet me dron/ UNIQA: Mbështetje më e shpejtë dhe më efikase në rast dëmi 21

“Jetojmë më mirë së bashku nuk duhet të mbesë thjesht një premtim, por të jetë e mbushur me veprime. Ajo është motoja mbi të cilën punojmë çdo ditë, duke u përpjekur të jemi sa më pranë klientëve tanë por edhe komunitetit ku operojmë”

Avni Ponari, CEO i Grupit “SIGAL UNIQA”, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

UNIQA Insurance Group

Intervista/ CEO i “UNIQA”: U japim siguri mbi 16 milionë njerëz në Austri dhe pothuajse të gjithë Evropën Juglindore

“Industria evropiane e sigurimeve është investitori më i madh i kontinentit. Qoftë kriza klimatike apo sistemi i kujdesit shëndetësor: kompanitë e sigurimeve si UNIQA kanë shumë mundësi për të vendosur drejtimin në të cilin duhet të zhvillohet bota jonë”.

Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group, në një intervistë për të përditshmen “Die Presse”, shpjegon se ku e sheh potencialin më të madh dhe pse është optimist për të ardhmen. “Industria evropiane e sigurimeve menaxhon 11 trilion euro. Varësisht se ku do të drejtohen këto investime do të jetë vendimtare nëse BE do të ketë sukses në tranzicionin e gjelbër”, thekson Andreas Brandstetter.

Ai sheh nevojën për veprim në fushën e dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, pasi barra e tyre o rritet.

Sipas tij, qëllimi është që rreziqet natyrore të bëhen plotësisht të sigurueshme, në mënyrë që njerëzit të marrin kompensim të plotë dhe të kenë një pretendim ligjor. Por kjo kërkon ende vullnet politik.

Në 10 vitet e ardhshme ne do të përjetojmë më shumë ndryshime sesa kanë ndodhur në 100 vitet e fundit. Dhe Brandstetter e sheh këtë si një mundësi:



““Për shembull, mbi 150 milionë euro në vit derdhen në fushat e inteligjencës artificiale, të dhënave të mëdha, IT, etj. Të gjitha fushat që na bëjnë të sigurt për të ardhmen”, thotë CEO i UNIQA. Sa i përket sigurimeve shëndetësore, “UNIQA” mbetet lider në Austri dhe Evropë.
“Shëndeti është në ADN-në tonë“, thotë Brandstetter.

Mbi 16 vite “UNIQA” në Shqipëri dhe rajon

“UNIQA” ishte dallëndyshja e parë nga Europa që vendosi të investojë në tregun financiar shqiptar dhe atë të rajonit dhe sot është më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

23 mars 2007 ishte data do të shenjonte një moment shumë të rëndësishëm në jetën ekonomike dhe financiare të vendit por edhe të tregut të sigurimeve në veçanti: partneriteti SIGAL – UNIQA Insurance Group.

20-vjetori / SIGAL UNIQA – Kosova, simbol i besueshmërisë, përgjegjësisë dhe shërbimit ekselent ndaj klientit



SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë kremtoi këtë të hënë 20-vjetorin e themelimit të saj.

Në një event të organizuar në kryeqytetin Prishtinë me pjesëmarrjen e drejtuesve të kompanisë, autoriteteve vendase dhe qindra të ftuarve të tjerë, kompania lider në tregun e sigurimeve festoi ditëlindjes e saj të 20-të.

Një rrugëtim i vështirë, i mbushur me plot sfida por në të njëjtën kohë i suksesshëm teksa tani shohim që SIGAL UNIQA Group Austria është një emër që ka shenjuar historinë e sipërmarrjes së lirë në Kosovë, njësoj si në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut dhe adresa e parë për çdokënd që do të sigurojë jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe çdo gjë tjetër me vlerë.

Gjatë fjalës së tij, themeluesi dhe drejtuesi i Grupit "SIGAL UNIQA" në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, z. Avni Ponari u shpreh ndër të tjera se këto dy dekada kanë kaluar shumë shpejt por mbartin brenda tyre mijëra orë pune, mendimesh, idesh ndaj dhe sot kompania është lidere në tregun e sigurimeve, jo vetëm në Kosovë.

"Për 20 vite qëndrueshmëri dhe punë efektive, Ponari tha se janë investuar mbi 12 milionë euro në Kosovë.

Në këto 20 vite ne në Kosovë kemi investuar 12.5 milionë euro, kemi bërë një xhiro në total rreth 202 milionë euro, kemi paguar mbi 100 milionë euro dëme, dhe natyrisht që pjesa më e vogël është pjesa e fitimit të aksionarëve dhe kompanisë, devidenti i tyre në 20 vjet është shumë i vogël, pra, çdo gjë e bëmë në investim dhe interes të ngritjes së kompanisë në Kosovë.

Shpresojmë që nga kjo ditë, ta quajmë si dita e fillimit, dhe ta mendojmë këtë kompani si biznes i tashmes", tha nder te tjera z.Ponari duke falenderuar stafin e punonjesve per punen e kryer gjate ketyre viteve dhe klientet per besimin e dhene", u shpreh CEO i SIGAL UNIQA Group Austria.

Por në një ngjarje kaq të rëndësishme për SIGAL UNIQA – Kosovë nuk mund të mungonte përshëndetja e CEO-s të "UNIQA Insurance Group", njëherazi aksionere kryesore e Grupit, z. Andreas Brandstetter.









Në video-mesazhin dërguar, z. Brandstetter, teksa uroi ditëlindjen e 20-të të SIGAL UNIQA në Kosovë, u shpreh ndër të tjera se, misioni i kompanisë që ai drejton është ofrimi i shërbimeve dhe produkteve të klasit të parë te më shumë se 16 milionë klientët tanë që UNIQA ka në thuajse të gjithë Europën.

Gjatë fjalës përshëndetëse të tij, z.Brandstetter theksoi se Europa ka shumë për të ofruar dhe është premtuese për të rinjtë, për gjeneratat e ardhshme, për të ndërtuar një shoqëri që jeton në paqe dhe në harmoni, një shoqëri jetëgjatë. Sipas tij, ky është gjithashtu misioni "UNIQA" në Kosovë.

CEO i "UNIQA Insurance Group" e mbylli video-mesazhin e tij duke theksuar faktin se ndjehet krenar për arritjet e SIGAL UNIQA në Kosovë ndaj nuk mungoi të shprehte mirënjohjen e tij për stafin drejtues të kompanisë, punonjësit por mbi të gjitha për klientët.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA - Kosova u themelua në 23 tetor 2003 në kuadër të ndërkombëtarizimit të aktivitetit të SIGAL sh.a, përmes blerjes së një kompanie ekzistuese të sigurimeve.

Ajo do të licensohej nga licencuar Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të përgjithshëm të jo-jetës. Ndërsa në vitin 2011 në Kosovë do të themelohej edhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA, e licencuar si kompani e sigurimit të jetës.

Sot kompania është lidere e tregut të sigurimeve si për pozicionin që ze në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj.


Ajo zë 14% të tregut në sigurimet e Jo-Jetës dhe është e para edhe në pagimin e dëmeve me 19% të totalit të 12 kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë.


Si pjesë e një grupi rajonal sigurimesh, me 8 kompani në përbërje, 1.5 milionë klientë, mbi 100 milionë prime vjetore dhe 500 milionë dëme të paguara që prej vitit 1999, SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë është gjithmonë pranë klientëve, atëherë kur ata kanë më shumë nevojë!

Ajo është e fokusuar dhe e angazhuar për të sjellë tek qytetarët dhe bizneset e Kosovës produktet dhe shërbimet më novatore, në mënyrën më të lehtë e të thjeshtë të mundshme sepse me **"SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku".**

Raporti i AMF/ SIGAL UNIQA Group Austria, lideri i vërtetë i sigurimeve

SIGAL UNIQA Group Austria është kompania lider e sigurimeve në Shqipëri, si për sigurimet e jo-jetës ashtu edhe për ato të jetës.
Këtë nuk e thonë drejtuesit e kompanisë por raporti i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2023.
Sipas raportit, SIGAL UNIQA ruan lidershipin në treg, si për primet e shkruara ashtu edhe për dëmet e paguara.
Në Sigurimet e Jo-Jetës SIGAL UNIQA kryeson me 27% nga 8 kompani që operojnë këtë treg. Ndërsa për dëmet kryeson me 23%.
Sa i përket dëmeve në vlera konkrete, për periudhën janar-shtator 2023, SIGAL UNIQA Group Austria ka paguar tek klientët e saj mbi 1 miliard lekë dëmshpërblime.





Edhe sa i përket ndarjes së tregut, sipas sigurimeve të detyrueshme dhe ato vullnetare, sërish SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve.

Në Sigurimet e Jetës, kryesimi i SIGAL Life UNIQA është evident.

Ajo mbetet lider në treg duke zënë afro 46% të totalit.

SIGAL Life UNIQA nuk ka rivalë as në dëmshpërblimin e klientëve teksa ka paguar 52% të totalit të tregut. Thënë në shifra konkrete, nëse 4 kompanitë së bashku kanë paguar 214,953,000 Lekë, ajo rezulton të ketë paguar plot 111,288,000 Lekë.
ipas shifrave të AMF, nëse do të llogarisim totalin e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Jo-Jetë dhe Jetëm ku operojnë 12 kompani, SIGAL UNIQA Group Austria ze 28,2% të tij.
PSE KY BESIM I PALËKUNDUR TEK KJO KOMPANI?
Shërbimi profesional ndaj klientëve, pagimi i drejtpërdrejtë i dëmeve dhe risitë që sjell vazhdimisht në treg janë disa prej arsyeve pse SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.
Të përkushtuar dhe me profesionalizëm, mbi 2400 punonjës dhe agjentë të SIGAL UNIQA shërbejnë në mbi 1200 zyra në 3 shtete (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) me standarte tërësisht europiane duke qenë pranë mbi 1,2 milion klientëve atëherë kur ata kanë më shumë nevojë.
Ndaj, edhe sot, pas afro 25 vjetësh në treg, kjo kompani mbetet adresa numër 1 për cilindo qytetar që do të sigurojë jetën, shëndetin, pronën, automjetin e çdo gjë tjetër me vlerë.

SIGAL UNIQA, mes 'Top 50' kompanive më të mëdha të sigurimit në Evropën Juglindore

Kompania e sigurimeve "SIGAL UNIQA Group Austria", nuk është thjesht më e madhja dhe më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.
Kompania e themeluar në vitin 1999 dhe pjesë e "UNIQA Insurance Group" është edhe një ndër më të mëdhatë në Evropën Juglindore.
Sipas "Top SEE 100 Insurers", publikuar nga "See News", SIGAL UNIQA, e cila gjatë vitit 2021 rënditej në vendin e 51, është rritur me 3 pozicione për vitin 2022 duke hyrë në Top 50 (vendi 48).



Grupi "SIGAL UNIQA" ka shënuar rritje jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.
SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova renditet në vendin e 92-të nga vendi i 98-të (2021), ndërsa UNIQA në Maqedoninë e Veriut është në pozitën e 85-të, duke u përmirësuar me dy pozicione krahasuar me një vit më parë.
Sipas CEO-s së Grupit, z.Avni Ponari, viti 2022, edhe pse i vështirë për shkak të luftës në Ukrainë dhe pasojave që vijojnë të ndihen nga pandemia "COVID-19", ka qenë i suksesshëm për SIGAL UNIQA Group Austria-n.
"Viti 2022 nuk ka qenë shumë i lehtë. Pasojat e pandemisë botërore COVID-19 vijojnë ende të kenë ndikim, sulmi rus në Ukrainë ka pësuar ulje dhe ngritje të shpeshta, duke na e bërë jetën jo fort të sigurt. Por pavarësisht këtyre, 2022 ishte edhe një vit që na dha përparësi në udhëkryqe të reja, që na drejtojnë në rrugëtime të cilat nuk i kemi hasur më parë. Baza jonë solide dhe elastike e ka bërë 'SIGAL UNIQA Group Austria' lehtësisht të adaptueshëm në situata të panjohura dhe të thjeshtë për të reaguar shpejt në situata në ndryshim", shprehet ai.
"Top SEE 100 Insurers" është një renditje vjetore e kompanive më të mëdha në Evropën Juglindore, sipas të ardhurave totale për vitin 2022. Ajo mbulon kompanitë financiare të regjistruara në Shqipëri,Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Moldavi, Mali i Zi, Rumani, Serbi dhe Sllloveni.



Ponari në “Wake UP”: Mbështetje financiare që secili të diagnostikohet dhe kurojë kancerin

Teksa jemi ende në tetor, muaji i sensibilizimit kundër kancerit të gjirit, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria, z. Avni Ponari ishte i ftuar mëngjesin e sotëm në emisionin “Wake UP”, në Top Channel dhe Top Albania për të folur mbi produket e sigurimit të shëndetit që ofron kompania më e madhe e sigurimeve në vend dhe çfarë i mundësojnë ato qytetarëve.

Z.Ponari përmendi fillimisht disa fakte mbi shtimin e rasteve me sëmundje kancerogjene jo vetëm në Shqipëri pore dhe në Evropë dhe botë.

“Sot, studimet e kompanive më të mëdha të sigurimeve dhe risigurimeve në botë, Swiss Re, Munich Re, Allianz etj, konstatojnë se kanceri është një sëmundje e rrezikshme dhe e përbotshme. Sipas statistikave, në disa vende të Evropës shkon 1 me 2 ose në vende të tjera 1 me 3 ose 1 me 4. Pra, 1 në 2, 3 apo 4 persona është i prekur nga kanceri.

Kjo do të thotë se ky rrezik është evident dhe duke qenë i tillë duhet të jemi të kujdesshëm. SIGAL UNIQA është pjesë e një grupi të madh financiar dhe ne jemi mbështetje financiare dhe krijojmë mundësitë që secili të gjejë formën për ta diagnostikuar dhe kuruar sëmundjen. Parimi ynë është më mirë ta parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë”, u shpreh ai.

Sipas z.Ponari, kompania që ai drejton ofron produkte sigurimi shëndetësor dhe jo vetëm, inovatore dhe që të përballueshme për çdo shtresë të shoqërisë.

“Kemi dy produkte që janë të veçanta dhe të përbotshme. “Anti-Tumori”, që është një paketë e cila në rast dignostikimi të sëmundjes dhe me opinionin e dytë mjekësor, që ne marrim në Europë, përcaktojmë qartë tipin e sëmundjes.

Nëse sëmundja konstatohet, paketa përfshin çdo person, nga mosha 1 vjeç deri në 100 vjeç. Ndërsa “Jetë Plus” është një paketë ndryshe. Klienti gjen vetë spitalin kudo, në spitalet më të mira onkologjike të Europës. Këto sëmundje kanë nevojë të kesh besim te vetja, të kesh besim te ai që të shëron dhe me kostot e kurimit që mbulohen nga kompania e sigurimit.

Nuk duhet ta marrim kancerin si një sëmundje që po të zuri nuk shpëton. Në rast se mjekohesh mirë, në kohë dhe në klinikat e duhura 90% e rasteve janë të shërueshme”, deklaroi ai.

Shqipëria e rrezikuar, bujqësia e pasiguruar / Ponari: Kompanitë e sigurimeve në Shqipëri, të standarteve evropiane. Të gatshme të marrin përsipër rreziqet



utoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën Botërore organizoi në Tiranë, Konferencën Ndërkombëtare me temë "Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve – Mundësitë dhe Sfidat në Evropën Juglindore".

Në konferencë u diskutua për "Mundësitë dhe sfidat për zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Evropën Juglindore", "Roli i sigurimeve në menaxhimin e riskut të katastrofave" dhe "Sfidat për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi".

Panelistët, përfaqësues të nivelit të lartë të qeverisë shqiptare, institucionet financiare ndërkombëtare, autoritetet mbikëqyrëse financiare dhe pjesëmarrës të tregut vendas dhe ndërkombëtar, ndan mendimet dhe eksperiencat e tyre në lidhje me tregun e sigurimeve, praktikat botërore dhe nevojën për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve në rajon dhe në Shqipëri.

I ftuar në konferencë ishte edhe CEO i "SIGAL UNIQA Group Austria", z. Avni Ponari, i cili ishte pjesë e seksionit me temë "Sfidat për zhvillimin e sigurimit të bujqësisë dhe blegtorisë"

Gjatë fjalës së tij, CEO i Grupit "SIGAL UNIQA" u ndal te tregu i sigurimeve në Shqipëri dhe rajon duke u shprehur se ato tashmë kanë ekspertizën dhe përvojën për të operuar njësoj si çdo treg tjetër në Evropë.

"Nuk është e lehtë të flasësh pas këtyre eskpertëve megjithatë do mundohem të nxjerr diçka nga aktiviteti dhe përvoja ime në industrinë e sigurimeve, që nga fillimi i saj për të kuptuar çfarë është e mundur dhe çfarë duhet bërë.

SIGAL UNIQA është pjesë e një grupi të madh austriak. Prej vitit 2007 dy investitorë strategjikë, Vienna Insurance Group dhe UNIQA Insurance Group janë në të gjithë rajonin përmes dy kompanive shqiptare duke garantuar tregjet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.



Dhe kjo i ka bërë këto tregje më efikase dhe të punojnë me standarte evropiane", u shpreh z.Ponari.

Sipas tij, industria e sigurimeve në vendin tonë ka tashmë eksperiencën dhe aftësinë paguese për të marrë përsipër edhe rreziqet në bujqësi, ashtu si sigurimet katastrofike dhe sigurimet e tjera.

"Industria e sigurimeve në Shqipëri, për ekspertizën, eksperiencën, aftësinë paguese do të thoja që është e standarteve më të mira që mund të ketë një treg sigurimesh", tha ndër të tjera themeluesi dhe drejtuesi i "SIGAL UNIQA Group Austria".

Bujqësia është një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, e cila, në masë të madhe, është e ekspozuar ndaj kushteve atmosferike, të nxitura edhe si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Ndaj Sigurimi i Bujqësisë është një mjet i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut që ndihmon fermerët të mbrohen nga humbjet financiare për shkak të fatkeqësive natyrore dhe kushteve klimatike.

Dhe sipas z.Ponari, kompanitë e sigurimeve në Shqipëri janë të gatshme të marrin përsipër edhe rreziqet në këtë sektor.

"Duke qenë në këto pozita, edhe në fushën e bujqësisë ka të gjitha mundësitë që të organizojë dhe ta drejtojë atë me shumë sukses. Të organizojë dhe drejtojë edhe sigurimet .

katastrofike, edhe sigurimet e tjera, të cilat janë

në procese diskutimi dhe për të cilat ne kemi mendimet tona, për shkak të eksperiencës sonë"

Ajo që dua të them dhe që është e rëndësishme, tregu i sigurimeve në Shqipëri, sigurimet në bujqësi, sigurimet vullnetare, shëndeti, pasuria janë sigurime me specifika të ndryshme në çdo vend. Secili vend ka specifikat e tij. Ashtu si çdo rreth në Shqipëri ka specifikat e veta. Unë operoj në tre shtete dhe në të trija shtetet, pavarësisht se produkti ka të njëjtin emër, ai ka brenda specifikat e ndryshme që janë shumë të rëndësishme për çdo vend", shtoi CEO i "SIGAL UNIQA Group Austria".

SIGAL UNIQA Group Austria ka kryer një studim, i cili tregon sa është vlera totale e aseteve të sigurueshme në bujqësinë dhe blegtorinë shqiptare dhe sa është primi vjetor për sigurimin e tyre.

"Ne kemi bërë një hulumtim dhe rezulton se totali i aseteve bujqësore që mund të sigurohen në Shqipëri është 2.5 miliardë Euro. Ndërsa primi vjetor për sigurimin e tyre është 80 milionë Euro".

"Kërcënimet në sektorin e bujqësisë janë të shumta, duke nisur nga moti, i nxitur edhe nga ndryshimet klimatike. Por në Shqipëri rreziqet kryesore janë breshëri dhe përmbytjet. Sa i përket pool-eve, ato janë evidente dhe të pranishme në të gjithë tregun shqiptar të sigurimeve duke paguar dëme të çdo lloj natyre", tha z. Avni Ponari.

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

jetojmë më mirë së bashku



Më të mirët në treg/ Edhe Florian Binaj ia beson KASKO-n e makinës SIGAL UNIQA-s

Pasiguritë në jetën tonë të përditshme sa vijnë dhe shtohen.

Përveç “surprizave” në shëndet, banesë apo biznes, janë shtuar edhe ato në automjete.

Të gjithë e dime se makina është shndërruar në një mjet të rëndësishëm të përditshmërisë sonë ndaj gjithmonë kemi apeluar që gjithëkush që posedon një të tillë të ketë edhe siguracionin KASKO, përveç atij të detyrueshëm TPL.

Njësoj si aktori dhe prezantuesi i njohur televiziv Florian Binaj, i cili sigurimin KASKO ia beson kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria.





SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

Sigurimi KASKO mbulon:

- Dëmtimet aksidentale
- Thyerja e xhamave,
- Vjedhja
- Zjarri, rrufeja, eksplozoni
- Katastrofat natyrore
- Dëmtim në parkim

Rrëshqitja e tokës dëmton kantierin në Tiranë/ Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim, nevojë për çdo projekt



Sektori i ndërtimit është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Mbi të gjitha gjatë viteve të fundit.

Por ndërtimi është gjithashtu një proçes i ndërlikuar dhe i ekspozuar ndaj shumë rreziqeve që mund të shkaktojnë papritur vonesa dhe ulje të fitimeve.

Nëse ndërtesa nuk ka përfunduar ende, situata shpesh vështirësohet edhe më shumë, sepse kantieri nuk po përparon dhe ka kosto shtesë. Ndaj Sigurimi i të gjithë rreziqeve në ndërtim (CAR) është i nevojshëm për të parandaluar ndërprerjet dhe vonesat në projektet tuaja të ndërtimit.

Videoja e publikuar një ditë më parë nga "JOQ Albania" ku shihej se si rrëshqitja e dherave dëmtoi një kantier ndërtimi në Tiranë është shembulli më i mirë i asaj çka cituam më sipër dhe njëkohësisht duhet të jetë një "mësim" i mirë për ndërtuesit.

Ndaj nevojitet një partner i madh dhe i besueshëm.

Këtë partner ndërtuesit, projektuesit apo inxhinierët mund ta gjejnë vetëm tek SIGAL UNIQA, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, e gatshme të jetë e vëmendshme kundrejt detajeve dhe eventeve të paparashikuara, në mënyrë që ju të ecni përpara për plotësimin dhe arritjen në kohë të realizimit të projekteve tuaja.

Falë sigurimit në SIGAL UNIQA ju nuk keni pse të mendoni se, sa do të jetë humbja në rast se objekti dëmtohet nga rreziqet natyrore, tërmeti, përmbytja, rrëshqitja e tokës apo zjarri, eksplozioni, vjedhja, apo një punëtor nuk është i kujdesshëm pasi për gjithçka mendon kompania e sigurimit.

Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim (Constructors' All Risk)

Ky produkt është për të gjithë ndërtuesit e pallateve, fabrikave, uzinave, aeroporteve, urave, autostradave.

Polica e sigurimit nga SIGAL UNIQA ofron mbulimin në sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

Mbulon të gjitha dëmet e pësuara nga i siguruari kontraktuesi apo nënkontraktuesi i punimeve), ashtu edhe dëmet që i siguruari mund t'i shkaktojë (të tretëve.

Nuk duhet harruar se, seksioni i Dëmeve karshi të tretëve është i detyrueshëm me VKM nr.873 datë 27.12.2022 për projekte me vlerë mbi 100 milionë lekë. Sigurimi duhet të mbulojë dëmet karshi palëve të treta deri në 15% të vlerës totale të punimeve ndërtimore.

Por a ka përfitues nga ky lloj Sigurimi?

Sigurisht. Mbrohet shteti, investimi dhe investitori. Por janë të mbrojtura gjithashtu edhe palët e treta që mund të jenë prej e aksidenteve të ndryshme gjatë ndërtimit.

Atëherë, çfarë ka ndodhur? Pse ky lloj Sigurimi nuk është më i kërkuar nga investitorët, qoftshin ata institucione shtetëtore apo private?

Ka shumë pikëpyetje por ajo që dihet është fakti se në të gjitha këto ngjarje dhe aksidente shteti dhe investitorët janë humbësit më të mëdhenj, por edhe individët apo palët e treta të dëmtuara, të cilët nuk kanë përfituar asgjë.

Atëherë cila është zgjidhja?

Duhet që së bashku me lejen e ndërtimit të kërkohet edhe ky lloj Sigurimi. Sepse në asnjë vend të botës nuk mund të hedhësh një lopatë pa patur më parë Sigurimet që nevojiten në ndërtim.

SIGAL UNIQA Group Austria, përveç çmimeve më preferianciale në treg, ofron garancinë e kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend dhe të qënurit pjesë e "UNIQA Insurance Group", një prej emrave më të njohur të financave dhe sigurimeve në Austri dhe Europë.

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

jetojmë më mirë së bashku



Partneri juaj në sigurime

Rritemi më mirë së bashku.

SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve për të gjitha llojet e bizneseve sipas standardeve europiane.

- ✓ Pronë
- ✓ Përgjegjësi
- ✓ Garanci
- ✓ Makineri dhe Automjete
- ✓ Punonjësit

sigal.com.al

“Për ti shërbyer më mirë klientëve”/ Fundjavë trajnimesh me stafet e SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut



Me qëllimin rritjen e cilësisë profesionale të stafeve, çka përkthehet në shërbim më të mirë ndaj klientëve, Grupi “SIGAL UNIQA” zhvilloi këtë fundjavë një sërë seminaresh dhe trajnimesh në të trija shtetet ku operon Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

Në Shqipëri dhe Kosovë trajnimet ishin të dedikuara te Sigurimet Motorike dhe veçanërisht produkteve vullnetare si “KASKO” apo “AutoSOS”. Kjo e fundit risi për tregun rajonal, e ofruar vetëm nga kjo kompani.

Ndërsa në Maqedoninë e Veriut, “UNIQA” zhvilloi një seminar me punonjësit e saj ku tema kryesore ishte Sigurimi i Pasurisë.

Sipas drejtuesve të kompanisë, trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve është shumë i rëndësishëm sepse përfaqëson një mundësi të mirë për këta të fundit që të rrisin bazën e njohurive të tyre, të përmirësojnë aftësitë e tyre, për tu bërë më efektivë dhe mbi të gjitha për ti shërbyer në mënyrë sa më profesionale klientët aktualë dhe atyre potencialë.

Punonjësit e trajnuar mirë janë më të sigurt, më të angazhuar, më produktivitë dhe më të afërt me klientët.

Kjo është filozofia e SIGAL UNIQA Group Austria, kompania lider dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri.

Prej vitit 1999, kompania vijon të jetë brendi më i besuar për sigurimin e jetës, shëndetit, pronës, automjetit dhe pensionin privat.

Letra e hapur e Elvis Ponarit për bizneset: Siguroni të ardhmen e punonjësve tuaj me ‘SIGAL UNIQA Fond Pensioni’

CEO i “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, Elvis Ponari, përmes një letre të hapur fton të gjithë bizneset në vend që ti bashkohen Fondit më të madh të pensioneve private në vend dhe të përfitojnë bashkë me punonjësit e tyre nga benefitet që ky fond ofron.
“Ne po ju kontaktojmë ju, në Shqipëri dhe jashtë saj, me një mundësi ekskluzive për të përmirësuar mirëqenien financiare të punonjësve tuaj. Një nga mënyrat për të kryer këtë është duke ofruar punonjësve tuaj një plan pensioni të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të ardhmen”, shkruan ndër të tjera Ponari në letrën e tij.
Më pas, Ponari shton 4 arsyet pse partneriteti me “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” është i duhuri për çdo sipërmarrje.



Letra e plotë:

“Shpresoj që ky mesazh t’ju gjejë mirë. Unë quhem Elvis Ponari, dhe përfaqësoj SIGAL UNIQA Fond Pensioni, një institucion financiar lider i angazhuar në ndihmën e individëve, subjekteve dhe organizatave për të siguruar të ardhmen e tyre financiare.

Ne po ju kontaktojmë ju, në Shqipëri dhe jashtë saj, me një mundësi ekskluzive për të përmirësuar mirëqenien financiare të punonjësve tuaj. Një nga mënyrat për të kryer këtë është duke ofruar punonjësve tuaj një plan pensioni të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të ardhmen.

Në SIGAL UNIQA Fond Pensioni, ne ofrojmë zgjidhje pensioni të nivelit europian.

Ja pse duhet të konsideroni partneritetin me ne:

1. Ekspertiza: Me mbi 17 vjet përvojë në fushën financiare, kemi njohuri të thellë në këtë fushë dhe mund të përshtatim zgjidhje për të përmbushur nevojat unike të kompanisë suaj.
2. Përshtatja: Ne punojmë ngushtë me çdo klient për të projektuar një plan pensioni që përputhet me synimet e kompanisë suaj dhe preferencat e punonjësve tuaj.


3. Siguria: Ju ofrojmë sigurinë dhe mbrojtjen e investimeve të punonjësve tuaj, duke investuar në instrumenta financiarë të besueshëm (Obligacione Shtetërore).

4. Kënaqësia e Punonjësve: Ofrimi i një plani pensioni privat tregon angazhimin tuaj për mirëqenien financiare të punonjësve tuaj, duke rritur kënaqësinë e tyre në punë dhe besnikërinë.

Për të planifikuar një takim ose për të mësuar më shumë rreth shërbimeve tona, ju lutem përgjigjuni në këtë email. Ekipi ynë i ekspertëve është gati të përgjigjet në çdo pyetje që keni dhe t’ju udhëheqë në proces.

Ne presim mundësinë për të punuar me ju dhe kompaninë tuaj të nderuar.
Me respekt,
Elvis Ponari”

Mbyllet Maratona e Tiranës 2023, “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”, një prej mbështetësve të eventit ndërkombëtar



Maratona e Tiranës zhvilloi këtë të dielë edicionin e saj të shtatë ku afro 4500 vrapues, garuan në 4 kategori të ndryshme. Në kategorinë e 42 kilometrave, Podiumi u poshtua nga sportistet e huaja.

Te meshkujt nuk kishte surpriza, teksa 3 sportistët nga Kenia, Ezekiel Kipkorir, Leban Çeriot, Hosea Kiplaget bënë për vetë çmimin e madh.

Sa i përket kategorisë së femrave për 42 km në vendin e parë ishte Natalia Semenoviç që fitoi 5,000 euro, në vendin e dytë sportisja nga Kenia Hellen Jepkosgei me 3,000 euro dhe në të tretin shqiptarja Sonia Cekini me 2,000 euro.

Edhe kampiones kuqezi, Luiza Gega, nuk zhgënjeu më tokën shqiptare. Ajo doli e para në “half maratone” me 21 km duke lënë pas rivalet e saj nga Kenia.

Sa i përket katëgorive të tjera, në 10 km, podiumi ishte kuqezi për vajzat. E para u pozicionua Gresa Bakraçi nga Kosova, në vendin e dytë, Redia Dauti dhe në të tretin, Relaksa Dauti.

Te meshkujt me 10 km, i pari doli greku Panayiotis Kariskos në vendin e dytë, Bledar Messi dhe në të tretin Krzysztof Syznofski nga Poloni.

Çmime u ndanë dhe për veteranët e kësaj maratone si dhe për personat më aftësi të kufizuara.

Edhe këtë një ndër sponsorit zyrtarë të Maratonës së Tiranës ishte edhe Fondi më i madh i pensioneve private në Shqipëri, “SIGAL UNIQA Fond Pensioni”

Ashtu si kompania mëmë, “SIGAL UNIQA Group Austria”, edhe “SIGAL UNIQA Fond Pensioni” ka qenë vazhdimisht një mbështetës i fortë i aktiviteteve sportive, kulturore dhe jo vetëm, në Tiranë e në të gjithë Shqipërinë.

SIGAL UNIQA lider i sigurimeve edhe në Kosovë/ Mbi 9.4 milionë Euro dëme të paguara, më shumë se çdo kompani tjetër

Banka Qëndrore e Kosovës, autoriteti mbikqyrës i tregut të sigurimeve në Kosovë, publikon të dhënat mbi ecurinë e këtij tregu për periudhën janar-shtator 2023.

Sipas raportit të BQK-së, gjatë 9-mujorit, tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 11.94% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Volumi i primeve të shkruara bruto në krahasim me periudhën paraprake është rritur për 11,737,614 euro më shumë duke arritur gjithsej shumën prej 110,029,658 euro.

Sa i përket 12 kompanive që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova vijon të ruajë vendin e parë, si për primet e shkruara ashtu edhe për dëmet e paguara.



Sigurim Shëndetësor për futbollistët/ SIGAL UNIQA – Kosova: Mbetemi një mbështetje e fortë për sportistët dhe klubet



SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë një suportuese e madhe e Sportit. Pas një sërë sponsorizimesh në Shqipëri, rasti më i fundit ai i Futboll Klub Vllaznisë, edhe SIGAL UNIQA – Kosova vijon punën për të qenë gjithmonë pranë komuniteteve sportive edhe përmes policave të sigurimit shëndetësor.

Më date 25 tetor, në ambjentet e Federatës së Futbollit të Kosovës u bë shpërndarja e policave të sigurimit shëndetësor për klubet e Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës U-17 të vajzave.

Sipas Drejtorit të SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova, Përparim Drini, kompania do të vijojë edhe në të ardhmen të jetë një aleat i rëndësishëm i Sportit në përgjithësi dhe futbollit në veçanti.

Dita Kombëtare e Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, “UNIQA” dhuron bursa për studentët e Matematikës

Me rastin e 1 Nëntorit, Ditës Kombëtare të Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, UNIQA dhuroi dy bursa vjetore për studentë të Fakultetit të Shkencave dhe Matematikës, në Universitetin “Shën Cirilit dhe Metodij”në Shkup.

Bursat ju dhuruan dy studenteve nga Drejtori i Përgjithshëm i “UNIQA A.D“, z.Driton Azizi dhe Drejtoresha e Përgjithshme e “UNIQA Life A.D“, znj. Aleksandra Shkëmbi Antovska.

“Si kompani me përgjegjësi sociale, është kënaqësi për “UNIQA AD Shkup” dhe “UNIQA LIFE AD Shkup” të kontribuojë për edukimin dhe zhvillimin e karrierës së profesionistëve të rinj në vend”, u shprehën drejtuesit e kompanisë.

Nisma për bursa për matematikanët e rinj është meritë e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), e cila synon promovimin, ndërgjegjësimin dhe afirmimin në publik të profesionit të aktuarit, që është një veprimtari me rëndësi thelbësore në sigurime dhe në të njëjtën kohë një profesion shumë i vlerësuar dhe i mirëpaguar.

Ky është viti i dytë radhazi që industria e sigurimeve ndan bursa me rastin e Ditës së Sigurimeve.





Cilat teste ndihmojnë në diagnostikimin e kancerit?

Tipizim HPV
Pap Test

Përfitoni 50% zbritje nëse blini paketën TeleShëndet

Makina Lëvizëse e dëmeve, ‘myUNIQA’, Inteligjenca Artificiale dhe inspektimet me dron/ UNIQA: Mbështetje më e shpejtë dhe më efikase në rast dëmi



“UNIQA Insurance Group”, një prej emrave më të njohur në industrinë e sigurimeve në Austri dhe Evropë, punon gjatë gjithë vitit për ti ofruar miliona klientëve të saj jo vetëm produktet më të mira të sigurimit por në të njëjtën kohë edhe shërbime sa më profesionale dhe unike.

Makina Lëvizëse e dëmeve, aplikacioni myUNIQA, Inteligjenca Artificiale dhe inspektimet me dron janë tashmë një mënyrë e suksesshme për ti dhënë zgjidhje të menjëhershme kërkesave të klientëve të saj.

Edhe për shkak të ndryshimeve klimatike, në Austri, vera që sapo lamë pas, ka qenë e ngarkuar me ngjarje sigurimi.

Deri në fundin e shtatorit 2023, dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (stuhi ere, stuhi shiu dhe breshër) kapën vlerën kolosale prej 100 milionë eurosh.

Në muajin korrik dhe gusht, ‘UNIQA’ ka marrë gjithsej rreth 22,000 raportime për dëme.

“Më shumë dëme jo vetëm që do të thotë një barrë më e lartë për ne, por gjithashtu do të thotë më shumë punë. Prandaj, gjejmë vazhdimisht mënyra të reja përpunimi në mënyrë që të mund t’i ndihmojmë të prekurit.

Punonjësit që dolën me automjetin dedikuar dëmeve mundën të bënin çdo procedurë në terren, që nga hapja e dosjeve, te kontrolli i mbulimit dhe pasojat e dëmit dhe deri te pagesa e një dëmshpërblimi në mënyrë që qytetari i dëmtuar të ketë paratë në llogarinë e tij në kohë rekord“, shprehet Peter Humer, Anëtar Bordi dhe drejtues për “Customer & Market Austria” në “UNIQA Insurance Group”.

Sigurisht, dëmet mund të raportohen edhe në forma të tjera, siç janë edhe 400 pikat “UNIQA”, rrjeti më i madh në Austri.

Aplikacioni “myUNIQA” është gjithashtu i disponueshëm gjatë gjithë kohës për për të raportuar sa më shpejtë dhe sa më lehtë dëmet.

Pika historike në ekologjinë operacionale: 100,000 kWh energji diellore në vit në selinë e Vjenës, shmangen 21 ton CO2

Gjithashtu në Drejtorinë Provinciale Carinthia & East Tirol PV sistemi në përgatitje: kursime të energjisë elektrike prej 30 deri në 40%.

Prodhimi fotovoltaik u rrit 8-fish që nga viti 2020.

Inteligjen artificiale gjithashtu rrit shpejtësinë e shërbimit

Nëse ndihmoni shpejt, do të ndihmoni dy herë më shumë. Në 9 muajt e parë të vitit 2023, rreth 20,000 pretendime për dëm u krijuan automatikisht ndërsa falë Inteligjencës Artificiale 9,000 pretendime të tjera u dëmshpërblyen pa kaluar nëpër burokraci.

Grupi UNIQA

Grupi UNIQA është një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në tregjet e tij kryesore të Austrisë dhe Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL).

Rreth 21,000 punonjës dhe partnerë ekskluzivë të shitjeve u shërbejnë mbi 16 milionë klientëve në 17 vende.

Në Austri, UNIQA është grupi i dytë më i madh i sigurimeve me një pjesë tregu prej mbi 21%.

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

jetojmë më mirë së bashku



MERR PARATË DHE
KUJDESU PËR SHËNDETIN

ANTI TUMOR

NDIHMA FINANCIARE QË JU NEVOJITET NË LUFTËN KUNDËR TUMORIT

- Një siguracion dedikuar vetëm tumorit malinj dhe tumorit beninj në kokë
- Kualifikohesh për t'u siguruar vetëm me një deklaratë shëndetësore
- Tarifë mujore e përballueshme për këdo

DUKE FILLUAR
30€
NË VIT/
PERSON



Merrni përfitime në para për trajtimin e tumorit

- Pagesë e menjëhershme në varësi të shumës së siguruar
- Shuma e siguruar nga 5,000 euro, 10,000 euro 15,000 euro, 20,000 euro, 30,000 euro
- Opinion i dytë mjekësor nga spitalet më të specializuara në botë
- Për mosha nga 0 - 80 vjeç

sigal.com.al

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

Drejtoria e Përgjithshme
Adresa: SIGAL Business Center, Blv. "Zogu I", Nr.1 , Tiranë, 1001
Kutia Postare: 2387, Tel: +355 4 22 333 08, Nr Jeshil: 0800 31 31
E-mail: info@uniqa.al, Web: www.sigal.com.al